



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

Nr.1113, datë 24.12.2020

PËR

**MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË UDHËTIMIT, TË QIRASË SË
BANESËS DHE RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSFERIMIT PËR
PUNONJËSIT E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 22, pika 3, të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi që transferohet apo emërohet për herë të parë, jashtë vendbanimit, për nevoja dhe në interes të punës, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi.
2. Masa e pagesës së kompensimit të udhëtimit është:

a) nga 36 km deri në 60 km, në masën	8 000 lekë/muaj;
b) nga 61 km deri 100 km, në masën	10 000 lekë/muaj;
c) nga 101 km deri 150 km, në masën	13 000 lekë/muaj;
ç) nga 151 km deri 200 km, në masën	15 000 lekë/muaj;
d) mbi 200 km, në masën	20 000 lekë/muaj.
3. Për përfitimin e pagesës për kompensim udhëtimi punonjësi paraqet në njësinë ku është transferuar apo emëruar për herë të parë dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - a) kërkesën me shkrim, me gjenealitetet e plota, adresën e vendbanimit të tij/familjes, para transferimit apo emërimit, si dhe adresën ku banon përkohësisht vetë punonjësi dhe familja e tij;
 - b) fotokopjen e kartës së identitetit, si dhe të certifikatës familjare;
 - c) vërtetimin nga njësi administrative, për vendbanimin e familjes dhe të vetë punonjësit.

4. Punonjësi që transferohet apo emërohet për herë të parë, jashtë vendbanimit, për nevoja dhe në interes të punës, në një largësi mbi 36 km, kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese dhe rimbursimin e plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe/ose të familjes.
5. Punonjësi përfiton kompensim për qira banese, si më poshtë vijon:
 - a) banesë tipi 1 + 1, kur certifikata familjare e punonjësit përmban deri në dy pjesëtarë;
 - b) banesë tipi 2 + 1, kur certifikata familjare e punonjësit përmban më shumë se dy pjesëtarë.
6. Për përfitimin e pagesës së kompensimit për qira banese, punonjësi paraqet në njësinë ku është transferuar apo emëruar për herë të parë dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - a) kërkesë me shkrim, me gjenealitetet e plota;
 - b) fotokopje të kartës së identitetit dhe të certifikatës familjare;
 - c) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtat kushte;
 - d) vërtetim nga zyrat/drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi apo nuk ka aplikuar për legalizim banese në vendin ku është transferuar apo emëruar.
7. Dokumentacioni, sipas pikave 3 dhe 6 të këtij vendimi, përcillet te njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore.
8. Vlera e kompensimit të qirasë së banesës nuk do të jetë më e madhe se vlera e qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë, sipas vendimit të fundit të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.
9. Punonjësi përzgjedh njërin nga përfitimet, kompensim për qira banese ose kompensim udhëtimi.
10. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit miraton urdhrin për kompensimin e udhëtimit ose të qirasë së banesës.
11. Punonjësi përfitues njofton për çdo ndryshim të kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 6 të këtij vendimi.
12. Përfitimi i pagesës për kompensim udhëtimi apo qira banese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit, që nënkupton sistemimin me banesë në juridiksionin e qendrës së punës, ku punonjësi është transferuar apo emëruar. Kjo pagesë do të përfitohet për një periudhë deri në tre vjet.

13. Punonjësit që aktualisht trajtohen me kompensim udhëtimi, përfitimet t'u rivlerësohen sipas afatit dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
14. Shpenzimet e transportit të pajisjeve, në rast të transferimit apo të emërimit për herë të parë të punonjësit, në masën deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, rimbursohen kundrejt faturës.
15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.
16. Vendimi nr.595, datë 5.9.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe kufizimeve ligjore", shfuqizohet.
17. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe